

Buletini Mjedisor

MORATORIUMI I PYJEVE – MASË EKSTREME, POR E DOMOSDOSHME PËR T’I DHENË FUND SHKATËRRIMIT TË KËSAJ PASURIE



Më datë 11 janar 2016, u zhvillua konferenca për promovimin e Moratoriumit të Pyjeve, si dhe

paketa e Krimit Mjedisor, që po hartohet nga ministri i Shtetit në bashkëpunim me ministrinë e Mjedisit.

Në këtë konferencë mori pjesë Kryeministri z. Edi Rama, ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave z. Edmond Panariti, përfaqësues të shoqatave të pyjeve dhe të shoqërisë civile. Pas prezantimit të një filmi dokumentar për pyjet, fjalën e mori ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka.

Në fjalën e tij, ministri Koka bëri një përshkrim të shkurtër të situatës së trashëguar në 70 vitet e fundit, duke vënë theksin në një trashëgimi të mbarsur me deficite në fondin shqiptar të pyjeve.

Duke iu referuar masave të marra nga Ministria e Mjedisit në këto dy vite për të ndryshuar situatën e trashëguar në pyje, ministri Koka tha: “Gjetëm mbi 400 kompani, të cilat ishin të pajisura me leje shfrytëzimi të tokës dhe nëntokës shqiptare, por që nuk kishin lidhur as edhe një kontratë të vetme me Ministrinë e Mjedisit për të zhëmtuar atë sipërfaqe që po shfrytëzohin. Ne arritëm që në dy vite, të gjitha këto kompani të lidhin marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit dhe sot të jenë kontribues në rehabilitimin e sipërfaqeve që kanë

dëmtuar”.

Kreu i Mjedisit u shpreh më tej se vendosja e moratoriumit 10 vjeçar të pyjeve është një nga vendimet më historike e më të vështira të marra ndonjëherë në fushën e mjedisit. “Pas shumë konsultash rezultoi se të gjitha masat e marra nuk dhanë rezultatin e shumëpritur. Ne vazhdojmë të kemi një çekulilibër të shfrytëzimit të pyjeve në ringjalljen natyrore të tyre. Ky moratorium, besoj është e vetmja masë që do t’i japë një zgjidhje përfundimtare” – tha z. Koka.

Më pas fjalën e mori z. Janaq Male, drejtor i Federatës së Pyjeve dhe Kullotave Komunale (CNVP), i cili në prezantimin e tij i njohti të pranishmit me problematikën e vazhdueshme në pyje në dekadat e fundit. Fjala mbyllëse ishte e Kryeministrit të vendit, z. Edi Rama, i cili theksoi se “Sot, ne jemi në kushtet kur na duhet të reagojmë në mënyrën më të vendosur dhe më radikale të mundshme. Pasi, sot ne jemi në kushtet kur e shohim përpapa syve tanë dhe e ndiejmë çdo ditë atë që deri një apo dy dekada më parë mund ta tregonin vetëm analizat dhe diagnozat e një degradimi të filluar edhe përpara viteve ’90, por që pas viteve ’90 mori përmasa të frikshme.

Gandi thotë se “Toka ofron burime të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e çdo njeriu, por nuk mund të përballojë dot lakminë e gjithsecilit”.

Ajo çka përtejtojmë sot me përmbytjet është faktikisht fatura e papërbalueshme e lakmisë

së shumëkujt për të marrë atë që nuk i takon, për të ndërtuar aty ku nuk i takon dhe për të jetuar me çfarë nuk i ka takuar dhe nuk mund t’i takojë. E po ashtu, pa dyshim edhe të një verbërie apo injorance të frikshme të atyre që për vite me radhë kishin detyrën ta mbronin duke e mirëqeverisur këtë sektor kaq jetik dhe kaq delikat.

Shkatërrimi i pyjeve, shkatërrimi i lumenjve, i shtretërve të lumenjve, shfrytëzimi barbar për lëndë drusore, për lëndë ndërtimi, si edhe shkatërrimi i të gjithë infrastrukturës mbrojtëse, pritave, argjaturave, kanaleve kulluese, na ka sjellë vit pas viti në buzë të një humnerë, të cilën ne prej dy vitesh kemi marrë masë për ta shmangur. Por sot, pas dy vitesh jemi në kushtet kur duhet të shkojmë një hap më tutje dhe duhet të hedhim me kurajë dhe vendosmëri hapin e Moratoriumit 10-vjeçar, të ndalimit absolut të shfrytëzimit të pyjeve për qëllime fitimi, për qëllime industriale, për qëllime tregtare, për qëllime që shkojnë përtej nevojës jetike dhe imediate të banorëve të zonave të ndryshme për t’u ngrohur gjatë dimrit. Kjo e fundit, është e vetmja pjesë e pranueshme në këtë proces ku me çdo kusht ne duhet t’i vëmë fre të gjitha aspekteve të tjera të shfrytëzimit të pyjeve.

Pa dyshim, pyjet nuk janë shkatërruar vetëm nga çfarë është lejuar. Pyjet janë shkatërruar edhe për shkak të një aktiviteti kriminal, intensiv, të zhvilluar në ilegalitet dhe në bashkëpunim të plotë me struktura që duhet t’i kishin mbrojtur pyjet në vite e vite të tëra”.

VIJON FINANCI I QEVERISË GJERMANE PËR LIQENIN E PRESPËS



Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, dhe Ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë, z. Helmut Hoffmann,

firmosën sot Marrëveshjen Qeveritare “Rezervati Ndërkufitar i Biosferës Prespë”. Në këtë marrëveshje, sigurohet që Qeveria Gjermane do të financojë me një grant prej 3.5 milionë eurosh fazën e dytë të projektit “Rezervati Ndërkufitar i Biosferës Prespë”, me një kohë-zgjatje nga viti 2016 deri në vitin 2020.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Qeveritare, ministri Koka falenderoi qeverinë gjermane për kontributin e vazhdueshëm për mjedisin shqiptar dhe theksoi se faza e dytë e projektit do të realizojë një menaxhim më të mirë të pyjeve dhe përdorim më të mirë të burimeve natyrore.

“Objekti kryesor i Ministrisë së Mjedisit për pjesën e dytë të projektit për menaxhimin e

integruar të rezervatit ndërkufitar të Biosferës së Prespës është edhe përfshirja e komunitetit të zonës dhe përdoruesve tradicionalë në këtë zonë të mbrojtur. Investimet e deritanishme kanë ndihmuar ndjeshëm në zbutjen e varfërisë në zonë, në sensibilizimin e vetë banorëve për pasuritë natyrore, dhe, nga ana tjetër, për të pasur një administratë sa më cilësore, e cila vazhdon bashkëpunimin e ngushtë me agjencitë homologe në Maqedoni dhe në Greqi” - u shpreh ministri Koka.

Nga ana e tij, Ambasadori Hoffmann shprehu duke siguruar se Gjermania është e vendosur të vijojë më tej bashkëpunimin me Shqipërinë në fushën e mjedisit. “Gjermania përmes Bankës për Zhvillim, KfW, dhe në bashkëpunim me qeverinë shqiptare ka zhvilluar programin e Parkut Natyror të Prespës, i cili synon të krijojë barazpeshën mes mbrojtjes së biodiversitetit dhe zhvillimit ekonomik. Natyra nuk njih kufij shtetesh.” - u shpreh ai.

Projekti mbështetet mbi vlerat e krijuara nga projekti i parë i sapo-përfunduar “Rezervati Ndërkufitar i Biosferës Prespë” dhe përqendrohet në investimet e mëtejshme në Parkun Kombëtar të Prespës (PNP) në përfutim të popullsisë lokale, të diversitetit biologjik dhe një mbështetjeje fillestare për zhvillimin e Rezervës së re të Biosferës të miratuar nga UNESCO.

Qëllimi i Projektit është që të reduktojë shfrytëzimin mbi burimet natyrore të Rezervës së Biosferës Prespë, si edhe uljen e varfërisë për popullsinë lokale. Kjo do të kontribuojë në ruajtjen e biodiversitetit dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë në Parkun Natyror të Prespës dhe në pjesën shqiptare të Rezervës së Biosferës. Gjithashtu, është parashikuar që Parku Kombëtar i Prespës (PNP) do të kthehet në një zonë të mbrojtur model për Shqipërinë, duke u shndërruar edhe në një institucion trajnimi për zonat e tjera të mbrojtura dhe stafin e tyre.

| |
|---|
| NË KËTË NUMËR: |
| MORATORIUMI I PYJEVE—MASË EKSTREME, POR E DOMOSDOSHME PËR T’I DHENË FUND SHKATËRRIMIT TË KËSAJ PASURIE — FQ 1 |
| VOJON INSPEKTIMET PËR PYJET DHE FAUNËN — FQ2 |
| LEJET MJEDISORE DHUETOR 2015—FQ 3 |
| 27 JANARI, DITA E SHËRIMIT PYJOR SHQIPTAR— FQ4 |

“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmesuria e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitje dhe bashkëpunim veprimtarie, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.

VIJONË INSPEKTIMET PËR PYJET DHE FAUNËN

Fillimi i janarit ishte dhe fillimi i vitit për Inspektoriatin e Policisë Pyjore, institucionit në varësi të Ministrisë së Mjedisit. Ky inspektoriat ka vijuar kontrollet në kuadër të mbrojtjes së faunës së egër për zbatimin e Moratoriumit të Gjuetisë, si dhe në fushën e mbrojtjes së pyjeve nga prerjet e paligjshme. Gjatë periudhës 1-15 Janar 2016 janë kryer 245 inspektime, nga të cilat për gjuetinë 85 inspektime. Gjatë inspektimeve dhe monitorimit për gjuetinë e paligjshme, Inspektoriatit e Policisë Pyjore raporton se në zonën e Durrësit janë kapur në flagrancë duke ushtruar gjuetinë e paligjshme disa shtetas.

Për njërin nga kundrvajtësit është marrë masa administrative gjohë 100 mijë Lekë, ndërsa për 2 shtetasit e tjerë masa e marrë është ajo e ndjekjes penale, për armëmbajtje pa leje, duke ushtruar gjueti të paligjshme. Gjithashtu janë sekuestruar nga Inspektoriatit e Policisë Pyjore 4 armë gjahu. Në Fier janë identifikuar 2 raste gjuetie të paligjshme. Ndaj kundrvajtësve janë marrë masa administrative gjohë 80 mijë Lekë.

Për periudhën 05-18 janar 2016, Inspektorët e Inspektoratit të Policisë Pyjore në shkallë vendi kanë ko-

nstatuar shkelje nga individë apo subjekte në lidhje me lëndën drusore. Për shkeljet e konstatuara, Inspektoriatit ka vendosur 7 masa administrative, dënim me gjohë në vlerën 380 000 Lekë dhe kanë sekuestruar 17,2 m3 material drusor, lëndë punimi.

Ministria e Mjedisit u bën thirrje të gjithë qytetarëve të denoncojnë rastet e gjuetisë së paligjshme pranë Policisë së Shtetit ose pranë Inspektoriatit të Policisë Pyjore, në mbrojtje të faunës së egër dhe ekosistemit pranë zonave, ku jetojnë.

PUBLIKU GJERMAN NJHET ME BUKURITË NATYRORE TË VENDIT TONË



Media gjermane, ARD, mundësoi realizimin dhe publikimin e një reportazhi kushtuar mjedisit shqiptar dhe pikërisht të zonave më të bukura, që dallohen për larmishmërinë e florës dhe faunës. Ky reportazh, i cili zgjat 43 minuta, ka xhiruar pamje mahnitëse nga Alpet e Shqipërisë, në mjediset e Lagunës së Divjakë—Karavastësë, në zonën malore të Dangëlli - Langaricës, dhe janë ndaluar edhe në

Butrintin e lashtë e në Gjirokastrë, duke i bashkuar në një etyd të vetëm të gjitha bukuritë që shpalojnë flora dhe fauna e egër e këtyre zonave.

Kjo media e huaj u ka prezantuar shikuesve të saj një Shqipëri ndryshe, jo si një vend i zhurmës apo varfërisë, por si një vendi i bukurive të egra, ku gjenden habitate nga më të ndryshmet dhe me vlera natyrore të padiskutueshme. Ministria e Mjedisit me institucionet e saj të varësisë,

mediat dhe komuniteti lokal duhet të përpigjen t'i pasurojnë dhe të promovojnë këto vlera natyrore, t'i mbrojnë dhe t'i promovojnë ato.

Në faqen e tij, ky televizion gjerman ka shkruar: "Wildes Albanien - Në vendin e shqiponjave. Alpet shqiptare janë të pasura me livadhe dhe pyje të lartë, por është e vështirë për të hyrë atje. Një habitat ideal për shqiponjat. Nga perspektiva jonë, kamera i afrohet rajonit...".

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS JANAR 2015

| NR. | SUBJEKTI | AKTIVITETI | VENDNDODHJA | VENDIMI |
|-----|-----------------|---|-------------------|--------------------------|
| | BLEDI | VTH SHFRYTËZIM KROMI | KALIMASH, KUKËS | PLOTËSIM INFORMACIONI |
| 2 | NIKA BL | VP SHESH I MATERIALEVE INERTE | KALIMASH, KUKËS | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 3 | ALB INERT | VTH KARRIERË GURI GËLQEROR DHE FRAKSIONIM INERTESH | VELIPOJË, SHKODËR | PLOTËSIM INFORMACIONI |
| 4 | KUKËS INERTE | VTH SHFRYTËZIM I GURIT GËLQEROR | GJINAJ, HAS | PLOTËSIM INFORMACIONI |
| 5 | COLOMBO | VP GRUMBULLIM I MBETJEVE ELEKTRONIKE DHE MBUSHJE ME BOJË E KATRIÇEVE TË KOMPUTERAVE | TIRANË | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 6 | TAP | VP GJURMA E RE E POTOMIT | BERAT | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 7 | TAP | VP NDËRTIM I RRUGËS SË KALIMIT | BERAT | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 8 | DURIM SINAJ | VP RRIJJE E SHPENDËVE | FIER | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 9 | BL ARSI | VP SHFRYTËZIM MINERAR NËNTOKËSOR | KALIMASH, KUKËS | KËRKËSË E TËRHEQUR |
| 10 | LIMAK | VP VEND DEPOZITIM MBETJESH | KORGË | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 11 | LIMAK | VP VEND DEPOZITIM MBETJESH | KORGË | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 12 | LIMAK | VP VEND DEPOZITIM MBETJESH | KORGË | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 13 | MAG | VP NDËRTIM I KAT MAGAZINE PËR SERVIS | PATOS, FIER | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 14 | ALBCONTROL | VP GODINË SHËRBIMI | RINAS, TIRANË | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 15 | ALUMIL ALBANIA | VP SHKRIRJA E ALUMINIT | TIRANË | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 16 | AMES SEKSIONI A | VP NDËRTIM GODINE DHE TREGTIM MALLRASHI, FASONERI | VORË, TIRANË | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 17 | AMES SEKSIONI B | VP NDËRTIM GODINE DHE TREGTIM MALLRASHI, FASONERI | VORË, TIRANË | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |

| NR. | SUBJEKTI | AKTIVITETI | VENDODHJA | VENDIMI |
|-----|---|---|-----------------------|----------------------------|
| 1 | FSHZH | VP—SHËTTORJA E HIMARËS | HIMARË, VLORË | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 2 | BLUE EYE WATER | VP—PRODHIM UJI | VLORË | SHTYRJE |
| 3 | HEC VERNIK | VP—NDËRTIM I HIDROCENTRALIT NË KASKADËN VERNIK | SMOKTHINË, VLORË | VENDIM PËR VNM TË THELLUAR |
| 4 | CIV | VP—FABRIKË PËR PËRPUNIM DHE AMBALAZHIM UJI | FTERRË, LUKOVË, VLORË | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 5 | ATU -ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION" | VP—PUNIME INFRASTRUKTURË PËR SHTRIMIN E FIBRËS OPTIKE | DURRËS | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 6 | OST | VP—NDËRTIM MAGAZINE QËNDRORE BRENDA TERRITORTIT TË NËNSTACIONIT RRASHBULL | RRASHBULL, DURRËS | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 7 | ATU -ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION" | VP—PUNIME INFRASTRUKTURË PËR SHTRIMIN E FIBRËS OPTIKE | FIER | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |
| 8 | AGRON GEGA | VP—KOMPLEKS BLEKTORIAL | FUSHË KRUIJË, DURRËS | VENDIM PËR VNM PARAPRAKE |

LEJET MJEDISORE DHJETOR 2015

| SUBJEKTI | AKTIVITETI | VENDNDODHJA | VENDIMI | TIPI I LEJES |
|-----------------------------------|--|--------------------------------|---------|--------------|
| MINING VENTURES ALBANIA (LC-4445) | NXJERRJE E MINERALEVE TË RËRËS DHE ARGJILËS NGA MINIERAT ME SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR DHE NGA GURORËT | OBJEKTI MELOVË, RRETHI SKRAPAR | MIRATIM | TIPI B |
| MINING VENTURES ALBANIA (LC-4447) | NXJERRJE E MINERALEVE TË RËRËS DHE ARGJILËS NGA MINIERAT ME SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR DHE NGA GURORËT | OBJEKTI MELOVË, RRETHI SKRAPAR | MIRATIM | TIPI B |
| AGI BES HALILI | NDRYSHIM | SHISHTUFINË, DAJT | MIRATIM | TIPI B |
| PRIMAGAS ALBANIA | GAZ NATYROR AROMATIK OSE GLN, PËRVEÇ RASTEVE KUR VEPRIMTARIA ËSHTË E LIDHUR ME TIPIN A OSE PËRZIERJE E AROMAVE | KATUND I RI, DURRËS | MIRATIM | TIPI B |
| ARTEMIS FARM | III.2.B GRUMBULLIM, TRANSPORTIM, RUAJTJE DHE RICIKLIMI MBETJEVE TË KAFSHËVE | VAQARR, TIRANË | MIRATIM | TIPI B |
| FJONA-2006 | III.2.B GRUMBULLIM DHE TRANSPORTIM I MBETJEVE DHE I UJËRAVE TË ZEZA | DURRËS | MIRATIM | TIPI B |
| ANTEA (LC-4576) | RISHIKIM | KRUJË, DURRËS | MIRATIM | TIPI B |
| ANTEA (LC-4571) | RISHIKIM | KRUJË, DURRËS | MIRATIM | TIPI B |
| ANTEA (LC-4575) | RISHIKIM | KOMUNA BORIZANË, KRUJË | MIRATIM | TIPI B |
| ANTEA (LC-4580) | RISHIKIM | KODËR THUMANË, KRUJË | MIRATIM | TIPI B |
| K.I.D-ALB (LC-4607) | RISHIKIM | MAMINAS, DURRËS | REFUZIM | TIPI B |
| K.I.D-ALB (LC-4604) | RISHIKIM | MAMINAS, DURRËS | REFUZIM | TIPI A |

27 JANARI, DITA E SHËRBIMIT PYJOR SHQIPTAR

Mesazhi i Ministrisë së Mjedisit, z. Lefter Koka, në përkujtimin e kësaj dite të shënuar për të gjithë ata që i kanë dedikuar shkollimin dhe punën e tyre pyjeve:

“Sot është një ditë e shënuar për pylltarin shqiptar! 93 vjet më parë u krijua Shërbimi Pyjor Shqiptar, një trupë e tërë inxhinierësh dhe specialistësh, që punuan me përkushtim për të ruajtur dhe për të zhvilluar një nga pasuritë më të vyerat kombëtare.

Sot është dita të kujtojmë veçanërisht pionerët e parë të këtij Shërbimi! Ata meritojnë respektin dhe mirënjohjen tonë për gjithçka bënë dhe trashëguan brez pas brezi!

Ju siguroj se devotshmëria, puna dhe pasioni i qindra inxhinierëve e punonjësve të pyjeve është busull e politikës së Ministrisë së Mjedisit për një zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve, me detyrimin për t'u lënë fëmijëve tanë një mjedis të shëndetshëm dhe të bukur!”

PAK HISTORI


27 janari u shpall si “Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar”, në kujtim të datës 27 janar të vitit 1923, kur u miratua “Ligji i parë shqiptar i pyjeve dhe kullosave”.

Që në themelimin e shtetit shqiptar, ka pasur përpjekje për të ngritur dhe organizuar një shërbim pyjor, për mbrojtjen dhe administrimin e pyjeve si ndër pasuritë më të çmuara të kombit. Shërbimi pyjor shqiptar ka historinë e tij të zhvillimit, arritjet dhe kontributin në tërësinë e vlerave të kombit shqiptar. Ka personalitete që kanë kontribuar në ruajtjen dhe zhvillimin e pyjeve.

Vlen të përmendim në këtë ditë themeluesit e silvikulturës shqiptare dhe drejtuesit e shërbimit pyjor para çlirimit, si Mete Shahu (i pari inxhinier pyjesh shqiptar), Ilia Mitrush (pionierin e botanikës shqiptare) Ljazar Treska (themeluesin e arsimit pyjor shqiptar), Ilia Nako (inxhinierin e parë të pyllëzimeve), Bernard Laca (doktorin e parë të shkencave pyjore), specialistët e tjerë si Fahri Rusi, Jorgji Llavda, Vasil Shqau, Muharrem Xhemali, etj., të diplomuar kryesisht në universitetet perëndimore, për të ardhur tek brezat e specialistëve të tjerë të pasçlirimit, si

Vehbi Dermeni (projekuesin e zbatuesin e pyllëzimeve të zonës bregdetare), Piro Xhumetiku (projekuesin dhe zbatuesin e pyllëzimeve të kodrave të Pukës), Perlat Qorri (projekuesin dhe zbatuesin e pyllëzimeve të Beratit), Izmini Nako (e para grua inxhinierë pyjesh), Vaskë Tiko, Petro Dishnica, Irfan Çela, Hysen Selfo, etj. etj., të shkolluar kryesisht në vendet lindore. Mirënjohje dhe respekt për punën dhe kontributin e të gjithë pylltarëve veteranë!

Shërbimi pyjor, ka pasur disa forma të organizimit të tij. Në vitet 1945-1990, ka qenë kryesisht i organizuar në drejtori rajonale në rrethe, të cilat më vonë kaluan si ndërmarrje pyjore. Në nivelin qëndror ka funksionuar përgjithësisht si një drejtori brenda Ministrisë së Bujqësisë. Për rreth 15 vite ka pasur një Drejtori të Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave dhe Drejtori të Shërbimit Pyjor në rrethe. Që nga shtatori 2005 e në vazhdim, kemi nivelin më të lartë të organizimit të shërbimit pyjor si drejtori në Ministrinë e Mjedisit. Gjithashtu, në vitin 2013 kemi pasur një ndarje të Drejtorisë së Pyjeve, që merret me hartimin e politikave dhe Inspektoriatin e Shërbimit Pyjor që ndërmerr kontrollin dhe monitorimin e pyjeve në terren.



GALERI





Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë

Mali i Tomorrit

RUBRIKA NJOFTIMË

MINISTRIA E MJEDISIT ORGANIZON DISKUTIMIN ME PUBLIKUN PËR SHTYRJEN E AFATIT TË MEMORANDUMIT TË GJUISË. DËGJESA ORGANIZOHET DITËN E HËNË, DT.08.02.2016, NË MINISTRINË E MJEDISIT.

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT
Email: info@moe.gov.al

DËGJESAT E PUBLIKUT PËR MUAJN DHJETOR



Ditën e enjte, datë 07.01.2016, në ambientet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua dëgjesa e publikut për draft – Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor”.

Në këtë takim merrnin pjesë rreth 50 vetë, përfaqësues të stafëve akademike të Universiteteve të Tiranës, publik dhe privat, ekspertë të ndikimit në mjedis dhe auditimit mjedisor, përfaqësues të Organizatave jofitimprurëse në fushën e mjedisit, si dhe përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, që do të prezantonin draftin e hartuar.

Dëgjesa u hap nga z. Pëllumb Abeshi, i cili foli për rëndësinë që kishte seanca për t'i ardhur në ndihmë procesit të hartimit të legjislacionit mjedisor, e në veçanti të këtij drafti Vendimi të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor”.

Zoti Abeshi në fjalën e tij theksoi se ky draft synonte të unifikonte procedurat për ekspertizën mjedisore dhe synonte kualifikimin paraprak të tyre. Më pas z. Abeshi i dha fjalën znj. Ornela Shoshi, e cila bëri një prezantim të shkurtër të këtij drafti vendimi. Në fjalën e saj, znj. Shoshi u fokusua në risinë që do të sillte procesi i certifikimit të ekspertëve

mjedisor për hartimin e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, afatet kohore të testimit dhe ritestitimit, si edhe tarifën që do të aplikohen për këtë proces.

Në këtë dëgjese merrnin pjesë dy grupe: stafi akademik nga Universitetet e ndryshme, si dhe grupimi i ekspertëve mjedisorë dhe përfaqësuesit e shoqatave mjedisore.

Stafi akademik që merrte pjesë në takim kishte objekt të kundërshtisë së tyre, pikën 1 të Vendimit, në lidhje me specifikimin e bërë për dy departamentet e dy fakulteteve të Tiranës.

Kundërshtimet për dhënien e së drejtës së organizimit të kursit dhe testimit nga Universiteti Politeknik dhe Bujqësor u shprehën në takim nga Prof. Lulzim Shuke, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Prof. Ferdinand Bego, përfaqësues të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, si dhe nga Prof. Aleko Miho.

Gjithashtu, edhe përfaqësuesit e fakultetit të Gjeologjisë dhe Minerave kanë sjellë komentet e tyre me shkrim përmes profesor Spiro Thodhorjanit, të cilat janë protokolluar pranë Ministrisë së Mjedisit. Kundërshti për këtë kishte edhe nga Universiteti Polis.

Grupimi tjetër i ekspertëve mjedisorë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile kishin kundërshti për të gjithë aktin në tërësi pasi nuk ishin dakort që t'i nënshtroheshin as provimit dhe as kualifikimit.

DËGJESË PUBLIKE E ORGANIZUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
Në datën 15 janar 2016, Agjencia Kombëtare e Planif-



ikimit të Territorit (AKPT), organizoi dëgjësën e publikut për “Prezantimin e Raporteve paraprake të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, për Planet Kombëtare të Territorit”.

Në takim u prezantuan: (i) Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Kombëtar; (ii) Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Integruar Ndersektorial të Bregdetit; (iii) Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Integruar Ndërsektorial të Zonës Ekonomike Tiranë-Durrës.

Në panelin drejtues merrnin pjesë znj. Adelina Greca, Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit; z. Redi Baduni, Drejtor, Drejtorja e Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit; znj. Ornela Shoshi, Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Ministria e Mjedisit dhe Moderatore e takimit; z. Andrian Vaso, Ekspert Mjedisor, Drejtues i Grupit të Punës për hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planet.

Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues të shoqatave mjedisore, pedagogë të Universiteteve të Tiranës, punonjës të administratës qëndrore dhe lokale.

Prezantimi i planeve të propozuara u bë nga z. Andrian Vaso, si drejtuesi i Grupit të ekspertëve që kanë hartuar këto tre plane. Gjatë dëgjësës pati komente dhe sugjerime nga të pranishmit, të cilat u morën parasysh nga hartuesit e këtyre dokumenteve strategjike.